



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1349/18 prot.

Datë 18.08.2025

V E N D I M

Nr. 1070/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga,

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.08.2025 mori në shqyrtim çështjen me

Objekt: Kërkesë për rishikimin e vendimit Nr. 992/2025, datë 31.07.2025 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-44425-04-09-2025, me objekt “Loti 2 “Mirëmbajtja e mjeteve të transportit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit” me fond limit: 4,000,000.00 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 25.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Drejtuar: Komisionit të Prokurimit Publik
Adresa: Pallati i Kongreseve, Kati i parë, Tiranë.

Kërkuesi: Operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK, me NIPT L62311016C dhe adresë : Rruga Nozllaku, Godine 2 kateshe, Kati 1, Zona Kadastrale 3866,Nr. Pasurie 287/28, Yrshek Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar , Ligji 97/2019 “Për miratimin e aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019 të këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 42 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin

dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, dëgjoi relatorin e çështjes, e pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 10.04.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-44425-04-09-2025, me objekt “*Loti 2 “Mirëmbajtja e mjeteve të transportit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”* me fond limit: 4,000,000.00 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 25.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

I.2. Në datën 25.04.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

I.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 05.05.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

Auto Manoku Servis	2,800,000 lekë	Kualifikuar
Totali i pikëve të marra: 300		
Vilnik Motors	2,797,700 lekë	Kualifikuar
Totali i pikëve të marra: 288,30		
Servis Auto 2000	2,978,900 lekë	Skualifikuar
AEE Service	3,000,000 lekë	Kualifikuar
Totali i pikëve të marra: 243,90		
Kadiu	3,624,304 lekë	Skualifikuar
Armando Panda	3,920,000 lekë	Skualifikuar

I.4 Në datën 21.05.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

I.5. Në datën 26.05.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5337 dhe me nr. 1349 prot., datë 27.05.2025, i operatorit ekonomik “Vilnik Motors” SHPK lidhur me vlerësimin me pikë të ofertës ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK, vlerësimin me pikë të ofertës ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK, si dhe vendimmarrjen e komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

I.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1349/1 prot, datë 28.05.2025.

I.7. Autoriteti kontraktor nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr. 1197/11 prot., datë 04.06.2025, protokolluar me tonën me nr.1349/2 prot., datë 05.06.2025, ka dërguar vendimin e KSHA nr.37/2025, datë 03.06.2025, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Vilnik Motors” SHPK. Referuar vendimit nr.37/2025, datë 03.06.2025 të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj.

I.8. Me shkresën nr.1349/3 prot., datë 10.06.2025, me objekt “*Mbi detyrimin e autoriteti kontraktor për dhënie informacion KPP-së...*” Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor duke i kërkuar informacion me përmbajtje si vijon: “*..Me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, procesverbalin e komisionit të vlerësimit të ofertave mbi pikëzimin e kriterëve të kualifikimit për secilin pjesëmarrës, si dhe dokumentacionin e plotë të dorëzuar pranë autoritetit tuaj kontraktor, nga operatori ekonomik “ Auto Manoku Servis ” SHPK, në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar”, sa i takon plotësimit të kriterit të kualifikimit të përcaktuar në shtojcën 9, “Formular i kriterëve të përzgjedhjes/ kualifikimit”/ 2. Kriteret e Veçanta të kualifikimit/ Kapaciteti teknik, pika 2.3.4.i e 2.3.4.o.”.*

I.9. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr.1197/17 prot., datë 11.06.2025 me objekt “*Dërgim dokumentacioni bazuar në shkresën nr.1349/3 prot., datë 10.06.2025*”, protokolluar me tonën me nr.1349/4 prot., datë 12.06.2025, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik procesverbalin e komisionit të vlerësimit të ofertave, datë 05.05.2025, si dhe dokumentacionin e operatorit ekonomik të shpallur fitues “Auto Manoku Servis” SHPK.

I.10. Me shkresën nr.1349/5 prot., datë 23.06.2025, Komisioni i Prokurimit Publik ju drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve duke i kërkuar informacionin si më poshtë:

[...] Cilët janë artikujt bashkëngjitur faturës xxx, datë 30.08.2024, [...].

I.11. Me shkresën nr.1349/6 prot., datë 23.06.2025, Komisioni i Prokurimit Publik ka vënë në dijeni palët se për shkaqe të nevojshme për verifikim, nuk është e mundur dalja me një vendim përfundimtar brenda afatit të parashikuar në ligjin e prokurimit publik.

I.12. Në kushtet kur nga ana e Drejtorisë së Përgjithëshme të Taimeve nuk u kthye përgjigje lidhur me kërkesën e bërë me shkresën nr. nr.1349/5 prot., datë 23.06.2025, KPP me shkrsën nr.1349/8 prot., datë 14.07.2025 i ridërgoi përsëri Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve kërkesën për paraqitjen e informacionit të kërkuar.

I.13.Me shkreesën nr. 13450/1 prot., datë 24.07.2025, protokolluar me tonën me nr.28.07.2025, Drejtoria Rajonale Tatimore ka vënë në dispozicion të Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar.

I.14. Në datën 30.05.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr.A/2025/5357 dhe me nr. 1395 prot., datë 02.06.2025, i operatorit ekonomik “AEE Service” SHPK., lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK dhe OE “Vilnik Motors” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

I.15. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1395/1 prot, datë 03.06.2025, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK dhe OE “Vilnik Motors” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

I.16. Autoriteti kontraktor, nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr. 1197/15 prot., datë 10.06.2025, protokolluar me tonën me nr.1395/2 prot., datë 11.06.2025 ka dërguar vendimin e KSHA nr.40/2025, datë 10.06.2025, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “AEE Service” SHPK. Referuar vendimit nr.40/2025, datë 10.06.2025 të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj.

I.17. Më datë 31.07.2025, Komisioni Prokurimit Publik, mori vendimin Nr. 992/2025, ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-44425-04-09-2025, me objekt “Loti 2 “Mirëmbajtja e mjeteve të transportit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit” me fond limit: 4,000,000.00 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 25.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara*

2. *Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “AEE Service” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
3. *Autoriteti kontraktor të rivlerësojë operatorin ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.*
4. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
5. *Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK.*
6. *Ngarkohet zyra e financës të kryej veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “AEE Service” SHPK,*
7. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
8. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.18.Përmes shkresës nr.105 prot., datë 13.08.2025, protokolluar me tonën me nr. 1349/16 prot., datë 14.08.2025 është paraqitur nga operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK kërkesa me lëndë “*Kërkesë për rishikimin e vendimit të KPP Nr.992/2025*”

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Në kuptim e zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij. (neni 24 i LPP).

II.1.1. Lidhur me shkresën e operatorit ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK me lëndë “*Kërkesë për rishikimin e vendimit të KPP Nr.992/2025*” përmes të cilës ka kërkuar rishikimin e vendimit Nr.992/2025, KPP nuk mund të komentojë apo shpjegojë vendimet e tij përtej shpjegimeve të bazuara në ligj dhe argumenteve faktike të cilat i ka paraqitur në pjesën “arsyetoi” të vendimit, kjo në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili përcakton se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, dhe merr vendime të cilat janë administrativisht përfundimtare (neni 24/1 i LPP).

II.1.2. KPP, gjen me vend të theksojë gjithashtu se ndërsa çdo subjekt i LPP ka të drejtë të interpretojë dispozitat e këtij legjislacioni, po ashtu, këto subjekte kanë edhe detyrimin ta

interpretojnë atë në përputhje e harmoni të brendshme dhe të jashtme me legjislacionin tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë. KPP në cilësinë e organit më të lartë në fushën e prokurimit publik, ka të drejtën dhe përgjegjësinë të bëjë interpretimin përfundimtar të legjislacionit të fushës përkatëse.

Akoma më tej, bazuar në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe përkatësisht në nenin 121 të tij, ashtu sikundër përcaktohet edhe në dispozitivin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, operatorët ekonomikë, në të gjitha rastet kur mendojnë se vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik kanë cënuar interesat e tyre të ligjshëm, mund të ndjekin hapat e mëtejshëm, për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 24/1 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Ligji 97/2019 “Për miratimin e aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019 të këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 42 e vijues, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri;

Vendos

1. Të mos pranojë kërkesën e operatorit ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK për rishikimin e vendimit të KPP-së Nr. 992/2025 datë 31.07.2025 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-44425-04-09-2025, me objekt “Loti 2 “Mirëmbajtja e mjeteve të transportit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit” me fond limit: 4,000,000.00 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 25.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

